



Zyra e Personelit

Nr.391/11

Vushtrri, më 18.10.2011

Në bazë nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Udhëheqësi i personelit, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

– **Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Urban**

I. Vendi i punës: **Zyrtar për planifikim**

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

-Propozon masa preventive me qëllim të pengimit të shkeljeve të dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e ndërtimtarisë;

-Ndihmon drejtorin në dhënien e të gjitha informatave profesionale në procesin e vendim marrjes;

-Ndihmon në procesin e hartimit të planit të qytetit, përdorimit të tokës së komunës dhe hapësirave publike;

-Merr pjesë në implementimin e strategjive zhvillimore të komunës;

-Ndihmon në hartimin dhe implementimin e strategjive zhvillimore të komunës;

-Punon në përgatitjen e projekteve dhe përcjellë realizimin e tyre;

-Ndihmon në përpilimin e planit zhvillimor të komunës dhe planeve rregulluese;

-Kryen edhe punë të tjera me urdhrin e drejtorit në pajtim me ligjin;

-Përgatit raporte javore, mujore dhe vjetore për punën.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

-Fakulteti i teknik, dega arkitekturë ose ndërtimtar

-Njohja e mirë e punës në kompjuter në programet word ,exel;

Koeficienti i pagës:7

Lloji i vendit të punës: pa afat

Periudha e provuese;një(1) vit .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet,të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Kandidatët të cilët kanë konkurruar në konkursin e datës 03.06.2011 , duhet vetëm aplikacionin ta plotësojnë.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Sektorin për menaxhimin e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Udhëheqësi i Personelit
Bislim Dushi**